
Transparenca dhe llogaridhënja në raportet financiare të agjencive të pavarura

Analizë Politikash

/2020



A large, abstract graphic element consisting of a bright yellow trapezoidal shape on the right side, a white diagonal line, and a dark grey area at the bottom left, all set against a white background.

Transparenca dhe llogaridhënja në raportet financiare të agjencive të pavarura

Autor: **Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)**

Programi: **Zhvillim i qëndrueshëm**

Publikimi: **Prill 2020**

Foto e ballinës: **Pexels**



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Ky punim është publikuar me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED). Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

Përmbajtja

Hyrje	2
Transparenca dhe llogaridhënja e Agjencive të pavarura në Kosovë.....	2
-- Transparenca dhe llogaridhënja në kryerjen e misionit të tyre.....	3
-- Transparenca dhe llogaridhënja financiare.....	3
Sfidat kryesore ne adresimin e transparences dhe llogaridhenjes (2 faqe).....	4
- Mungesa e unifikimit te konsultimeve publike	4
- Mungesa e pavaresise financiare (taksa e dedikuar etj)	4
- <i>Mungesa e instrumenteve te qarta te llogaridhenjes (flasim ktu ma gjonsisht tkallxoj cka po nenkuptoj)</i>	5
- Mungesa e mekanizmave te nxitjes se performances me te mire dhe matjes se performances.....	5
Përfundime dhe Rekomandime	5

Hyrje

Agjencitë e pavarura janë trupa institucional të cilët themelohen me ligj në bazë të nenit 142 të Kushtetutës së Kosovës. Sipas paragrafit 1 të këtij neni, agjencitë nuk janë pjesë e kompetencave të pushtetit ekzekutiv të Qeverisë sipas Kushtetutës. Agjencitë e pavarura gëzojnë një pavarësi në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre funksionale, organizative dhe në administrimin financiar në pajtim me ligjin. Poashtu, këta trupa institucional i shërbejnë Kuvendit për ushtrimin e mbikëqyrjes/kontrollit parlamentar të specializuar të ligjshmërisë dhe integritetit në fusha të caktuara të veprimtarisë administrative.

Agjencitë e pavarura janë të ndara në sektore të caktuar. Për secilin sektor të ekonomisë dhe industrisë së vendit, egzistojnë agjencitë e pavarura të cilat janë përgjegjëse për ngritjen, zhvillimin dhe zbatimin legjislativ të sektorëve të caktuar. Kjo pasiqë ekonomia e vendit nuk mund të jetë stabile dhe të vetërregullohet pa garantimin e institucioneve të veçanta shtetërore, prandaj edhe vendimet e caktuara sa i përket lëmvive të ndryshme të ekonomisë dhe industrisë, varen nga vetë agjencitë e pavarura.

Numri dhe funksioni i agjencive të pavarura varen nga nevoja reale e ekonomisë së tregut dhe e qytetarëve. Duke pasur parasysh se sukcesi, dështimi dhe llogaridhënja e tyre ndikojnë shumë në ekonominë e vendit, këto institucione kanë qenë dhe janë në qendër të vëmendjes dhe debatit brenda Kuvendit të Kosovës, qoftë në media dhe më gjerë. Prandaj, funksionimi dhe vendimet e marra nga ana e tyre kanë rëndësi të madhe në rregullimin e tregut dhe industrive të caktuara.

Veprimtaria e agjencive të pavarura mbikqyret në mënyrë të përhershme nga një nga komisionet e Kuvendit, të cilat mbulojnë fushat përkatëse. Këto komisione janë të obliguara të ndihmojnë në ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies së agjencive. Përmes tyre sigurohet një rritje e transparencës dhe llogaridhënjes së Agjencioneve të pavarura ndaj ekonomisë së vendit dhe opinionit të gjerë.

Në vitin 2019 është miratuar edhe Ligji nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura. Ky ligj përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore dhe të Agjencive të pavarura të themeluara nga Kuvendi i Kosovës. Qëllimi i tij qëndron në krijimin e një kuadri ligjor për themelimin, organizimin, funksionimin, përgjegjshmërinë dhe performancën e institucioneve të administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura.

Transparenca dhe llogaridhënja e Agjencive të pavarura në Kosovë

Agjencitë e pavarura të cilat janë të krijuara nga Kuvendi duhet të jenë të pavarura nga çdo institucion tjetër, të jenë apartiake, kompetente dhe t'i japin llogari pushtetit ligjbërës. Sa i përket kesaj çështje, pavarësia dhe funksionaliteti i Agjencive të pavarura është i rregulluar edhe me ligj. Ekzistimi i mekanizmave që sigurojnë pavarësinë funksionale të agjencive të pavarura ndihmon në balancimin e funksionimit të agjencive të pavarura.

Mbikqyrja efikase nga ana e Kuvendit ndaj agjencive të pavarura varet nga një numër i madh faktorësh dhe ngërthen në vete disa çështje kyçe që Kuvendi i Kosovës duhet të adresojë. Në rend të parë, sfidë mjaft e madhe mbetet transparencja dhe llogaridhënja e këtyre institucioneve.

Transparenca ndaj Kuvendit dhe qytetarëve të Kosovës nga ana e Agjencive të pavarura është shumë e rëndësishme. Kjo pasiqë vendimet të cilat miratohen nga këto institucione ndikojnë direkt në mirëqenien e qytetarëve të Kosovës. Përmes këtyre vendimeve preket edhe xhepi i qytetarëve të Kosovës, duke vënë në pikëpyetje kështu menaxhimin e parasë publike.

Transparenca sa i përket agjencive të pavarura mbështetet në përmbushjen e misionit të tyre dhe në raportimet e performancës së Agjencive. Këto raportime bëhen në Komisionet përkatëse të Kuvendit dhe në prani të shoqërisë civile përmes dëgjimeve publike. Përmes këtyre dëgjimeve, deputetët dhe opinioni i gjerë duhet të informohen rreth çështjeve dhe vendimeve të Agjencive të pavarura.

-- Transparenca dhe llogaridhënja në kryerjen e misionit të tyre

Përmes Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, neni 43, paragrafi 5 theksohet se “Çdo agjenci i paraqet komisionit përgjegjës raportin vjetor të performancës deri më datën 31 mars të vitit të pasardhës. Raporti vjetor i performancës përfshin informacion të detajuar për arritjen e objektivave, produkteve dhe rezultateve të përcaktuara në planin vjetor të performancës”. Përmes këtij paragrafi, Ligji obligon çdo Agjenci që të jetë transparente ndaj kryerjes së misionit të tyre dhe poashtu nga ana financiare.

Poashtu përmes këtij Ligji, kërkohet se përveç raportit vjetor, agjencia të paraqet, gjithashtu, raporte për periudha më afatshkurtra apo raporte për çështje të posaçme, nëse kërkohet nga komisioni përgjegjës. Si dhe çdo agjenci e pavarur duhet që për çdo vit të hartojë dhe të i propozojë komisionit përgjegjës planin vjetor të performancës për vitin e ardhshëm deri më 30 nëntor. Gjithashtu, çdo agjenci e pavarur detyrohet të publikojë, në ueb faqen e tyre zyrtare, Planin Vjetor të performancës, Raportin Vjetor të performancës, Raportin e Vlerësimit të performancës dhe Rezolutën e Kuvendit. Duke kërkuar kështu që të rritet transparencja e raportimit të agjencive të pavarura.

-- Transparenca dhe llogaridhënja financiare.

Agjencitë e pavarura përballen me probleme të theksuara në funksionimin e tyre, të cilat prekin edhe pavarësinë e tyre, edhe llogaridhënjen. Siç është theksuar edhe në botimet e mëherëshme të INDEP, Agjencitë e pavarura janë shprehur vazhdimisht në favor të rritjes së llogaridhënjes ndaj tyre. Shembull për këtë është manuali për raportim të agjencive të pavarura të cilin agjencitë e pavarura e kishin mirëpritur.

Llogaridhënja financiare, është e rregulluar poashtu me Ligjin nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura. Në nenin 40 , paragrafi 1 thuhet se “Agjencitë e pavarura gëzojnë pavarësi në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre funksionale, organizative dhe në administrimin financiar në pajtim me ligjin”. Përderisa, disa Agjenci e kanë mandat përgatitjen e buxhetit dhe i njëjti dërgohet drejtë në Kuvend për miratim, në raste të caktuara Agjencia përgatit buxhetin i cili përmes Qeverisë dërgohet në Kuvend. Si shembull i marrur nga INDEP në raportin “Rregullimi ligjor i Agjencive të Pavarura” që mund të marrim edhe në këtë rast është nga AAC, ku buxheti përgatitet nga drejtori i Përgjithshëm dhe i dorëzohet bordit mbikëqyrës. Bordi Mbikëqyrës i rishikon, ndryshon si e shih të nevojshme dhe të arsyeshme, dhe ia dorëzon këto dokumente Ministrisë të Financave. Buxheti i AAC-së miratohet pastaj nga Kuvendi i Kosovës.

Sfidat kryesore ne adresimin e transparencës dhe llogaridhënjes (2 faqe)

Edhe përkundër gatishmërisë së treguar nga ana e Agjencive të pavarura për rritjen e llogaridhënies, ende paraqiten sfida të cilat duhet kaluar adresimi i transparencës dhe llogaridhënjes. Këto sfida kryesisht paraqiten në pjesën e konsultimeve publike, pavarësisht financiare, llogaridhënjes dhe në nxitjen e performacës. Me përmirësimin e këtyre çështjeve, transparenca dhe llogaridhënja do pësonin një ndryshim mjaft pozitiv i cili do ndihmontë në përfshirjen më të mirë të qytetarëve të Kosovës në vendimmarrje.

- Mungesa e unifikimit të konsultimeve publike

Konsultimet publike paraqesin një element kyç të zhvillimit të proceseve ku qeveritë dhe institucionet e tjera publike të cilat hartojnë politika dhe ligje, planifikojnë, përgatisin, debatojnë, konsultojnë dhe përfundimisht miratojnë politika ose ligje. Duke pasur parasysh që Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP) është e ratifikuar edhe në Kosovë, atëherë, çdo qytetar do të ketë të drejta dhe mundësi të barabarta për të marrë pjesë në çështjet publike vendore, qoftë drejtpërdrejt, apo nëpërmjet Qeverisë ose Parlamentit.

Në një numër të madh të konsultimeve publike të Agjencive të pavarura mungon unifikimi i tyre. Në konsultimet publike të mbajtura nga agjencionet e pavarura duhet të vërehet një unifikim i konsultimeve publike në mënyrë që qasja e qytetarëve të jetë sa më e lehtë. Kjo do ndihmojë në ngritje e transparencës dhe llogaridhënjes nga ana e këtyre insitucioneve.

- Mungesa e pavarësisë financiare (taksa e dedikuar etj)

Në disa Agjencione të pavarura vërehet ende mungesa e pavarësisë financiare. Kjo pasi që sistemi i mbledhjes dhe menaxhimit të të hyrave në këto agjencione të pavarura nuk është mjaftueshëm i qartë. Taksat nga Qeveria e Kosovës mbledhen në dy forma: si të dedikuara dhe si të rregullta. Mirëo siç edhe theksohet në njërin nga shembujt e marrur në raportet e INDEP në lidhje me të hyrat e dedikuara, jo çdoherë ato adresohen në vendin e duhur.

Më së miri vlenë të theksohen dy raste ku njëri ka të bëjë me taksën ekologjike dhe rasti i Tarifës së sigurisë të AAC. Këto dy raste të trajtuara nga INDEP paraqesin vetëm dy raste nga shumë tjera të mbledhjes së taksave të dedikuara, të cilat nuk trajtohen si të hyra të dedikuara, por si të rregullta. Mbledhja e të hyrave si taksa dhe trajtimi i tyre si tatim është në kundërshtim me parimet e vendosjes së taksave që ka për pasojë mungesën e informimit të qytetarëve dhe rritjen e pakontrolluar të shpenzimeve dhe të qeverisë. Gjë e cila ende mbetet sfida e pakaluar nga ana e Qeverisë së Kosovës dhe Agjencioneve të pavarura.

- Mungesa e instrumenteve të qarta të llogaridhënjes (flasim ktu ma gjonsisht tkallxoj cka po nenkuptoj)

Sfidë për agjencitë e pavarura mbetet edhe paraqitja e instrumenteve të qarta të llogaridhënjes. Kjo pasiqë vërehet një mungesë e qartësimi sa i përket raporteve të këtyre institucioneve. Në Komisionet përkatëse zakonisht nga agjencionet e pavarura dorëzohet raporti vjetor. Rastet kur këto raporte janë jo të kompletuara janë të shpeshta.

Sfidë e mëtejme për ngritjen e transparencës dhe llogaridhënjes mbetet edhe kjo. Edhe pse Komisionet i vërejnë këto dallime dhe mungesa në raportime, nuk ka një instrument të qartë i cili sqaron se çfarë masa duhet ndërmarrë në rastet kur raportimi nuk është i duhur. Prandaj kjo edhe e vështirëson më shumë punën e deputetëve dhe e vë në dyshim transparencën ndaj qytetarëve të Kosovës.

- Mungesa e mekanizmave të nxitjes së performancës me të mire dhe matjes së performancës

Ndër sfidat që duhet theksuar, është padyshim edhe mungesa e mekanizmave të nxitjes së performancës së Agjencive të pavarura. Kjo do ndikonte në motivimin e Agjencioneve në ngritjen e transparencës dhe llogaridhënjes. Nuk ka asnjë përparësi dhe vlerësim qoft ai pozitiv apo negativ nga ana e Komisioneve apo Kuvendit sa i përket performancës mujore ose vjetore të Agjencioneve. Kjo bënë që Agjencionet të mos kenë një njësi matëse e cila do e ngriste performancën e tyre dhe do ndihmonte në shpërblimin apo ndëshkimin e mënyrës së raportimit nga ana e tyre.

Përfundime dhe Rekomandime

Mundësia e unifikimit të konsultimeve publike duhet të merret parasysh në një kohë më të shkurtër. Kjo pasiqë përmes pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, do ngritet transparenca ndaj përdorimit të drejtë të parasë publike. Kjo do ndihmojë poashtu në përfshirjen sa më të madhe të opinionit të gjerë në ngritjen e ekonomisë së vendit.

Pavarësia financiare mbetet ende sfida në vete. Duke u nisur nga fakti se Agjencitë e pavarura gëzojnë pavarësi në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre funksionale, organizative dhe në administrimin financiar në pajtim me ligjin. Duhet shqyrtuar mbledhje e

taksave dhe të hyrat e dedikuara për agjencionet e caktuara të shfrytëzohen për ato qëllime dhe jo të trajtohen si të hyra të rregullta.

Në mënyrë që të ngritet performanca e raportimit, duhet të ndërtohen instrumente të qarta të llogaridhënjes. Kjo për faktin se në asnjërin nen të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura nuk përmenden masat që duhet marrë në rast të raportimit të dobët nga ana e bordit të Agjencioneve apo ndonjë formë tjetër.

Hartimi i një dokumenti i cili sqaron masat që duhet marrë në raste kur performanca e bordeve është e mirë apo e dobët. Kjo pasiqë nuk egziston ndonjë formë e shkruar e cila do të shpërblejë apo te ndëshkoj në një mënyrë apo në një tjetër bordin apo anëtarët e atij agjencioni si rezultat i performancës së tyre. Kjo do ndihmonte në ngritjen e transparencës dhe llogaridhënjes së Agjencioneve të pavarura.

Përfundimet

Agjencitë e pavarura janë institucione të cilat i përgjigjen Kuvendit. Qasja e tyre ndaj Kuvendit dhe qytetarëve të Kosovës duhet të jetë sa më e lehtë. Raportet të cilat dorëzohen në Kuvend duhet të jenë sa më transparente dhe llogaridhënëse.

Nisur nga fakti se Agjencitë e pavarura duhet të jenë të pavarura nga çdo institucion tjetër, të jenë jo të politizuara, kompetente dhe t'i japin llogari pushtetit, puna e tyre është mjaft e rëndësishme. Zhvillimi i mekanizmave që sigurojnë pavarësinë dhe funksionimin e agjencive të pavarura, do të ndihmojë në balancimin e funksionimit të agjencive të pavarura. Kjo do të ndikojë direkt në ngritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Sfidat rreth transparencës dhe llogaridhënjes së Agjencive të pavarura kanë qenë mjaft të mëdha edhe vitet e kaluara. Në vitin 2019 është miratuar Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura. Ky ligj ka ndihmuar që disa nga çështjet kyçe për funksionimin e Agjencive të pavarura të zgjidhen dhe që këto institucione të fillojnë të merren më seriozisht nga ana e Kuvendit. Kjo pasiqë problemet e adresuara më herët si zgjedhja e bordeve e cila shumë herë ka qenë e lënë anash, e me këtë edhe është vënë në pikëpyetje funksionimi i përgjithshëm i këtyre agjencive.

Edhe pse disa nga sfidat e mëparëshme kanë filluar të trajtohen me më shumë seriozitet, agjencitë e pavarura vazhdojnë të përballen ende me disa nga to. Ndër sfidat më të mëdha mbetet mungesa e unifikimit të konsultimeve publike. Kësaj sfide duhet të i ofrohet zgjidhje sa më e shpejtë në mënyrë që transparenca ndaj deputetëve dhe qytetarëve të jetë sa më e lartë.

Pavarësia financiare, qartësia e instrumenteve të llogaridhënjes dhe mungesa e mekanizmave të nxitjes së performancës më të mirë dhe matjes së performancës janë disa nga sfidat që përballen. Këto sfida jo vetëm që ndikojnë në menaxhimin më të lehtë të ekonomisë dhe industrisë së vendit, por edhe në ngritjen dhe funksionimin më të mirë të tyre. Prandaj këto janë si njësi matëse të cilat do ndikojnë mjaft në ngritjen e tyre.

